



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:205638

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05489185

PPP.nr.319/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Blerim Istrefi, në çështjen përmbartimore juridike të kreditorit SH.A. KUR “Mitrovica” J.S.C., me numër fiskal 600338033, adresa Rr.“Bislim Bajgora” p.n., Mitrovicë, kundër debitorit V. M Rr. Zh. K-M, për shkak të pagesës së borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.4977/2020 të datës 18.12.2020, të Përmbartuesit, jashtë seancës, me datë 22.03.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT** prapësimi i debitorit V.M nga M **SHFUQIZOHET** pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.4977/2020 të datës 18.12.2020, për detyrimet që rrjedhin për periudhën kohore prej datës 31.03.2016 e deri më datën 31.12.2018, në shumën prej 1,445.50€.
- II. Mbetet në fuqi** pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e Përmbartimit P.nr.4977/2020 të datës 18.12.2020, në pjesën për përmbartimin e detyrimit të debitorit V.M nga M, ndaj kreditorit SH.A. KUR “Mitrovica” J.S.C., me seli në Mitrovicë, për borxhin kryesor për shfrytëzimin e ujësjellësit dhe shërbimeve të kanalizimit për periudhën kohore prej datës 01.01.2019 deri me datën 30.11.2020, në shumën prej 392.30€, së bashku me kamatëvonesën të llogaritur mbi këtë shumë, sipas normës vjetore të interesit prej 8%, nga data e nxjerrjes se kati aktvendimi, e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto brenda afatit 7 ditor nga pranimi i këtij aktvendimi, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit SH.A. KUR “Mitrovica” J.S.C., me seli në Mitrovicë, me datë 18.12.2020 ka lëshuar Urdhrin përmbartimor P.nr.4977/2020 të datës 18.12.2020 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht kartelës financiare të konsumatorit, të datës 02.12.2020, në emër të debitorit V.M nga M, për shfrytëzimin e ujësjellësit dhe shërbimeve të kanalizimit për periudhën kohore 31.03.2016 gjerë më datë 30.11.2020, në shumën prej 1,837.80 €, me të cilin ka kërkuar që të

detyrohet debitori që kreditorit t'ia paguaj borxhin kryesor, së bashku me kamatën ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit ose të bëhet regjistrimi dhe sekuestrimi i sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor me datë 25.07.2023, debitori ka paraqitur prapësim në të cilin ka deklaruar se e kundërshton propozimin për përmbarim për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike pasi që për sasinë e harxhimit të ujit faturimin është bërë në mënyrë paushall duke kalkuluar gabimisht nga zyrat e saj, gjithashtu në bazë të nenit 360 të LMD-së është parashkruar borxhi pasi që në bazë të veprimit të kreditorit, pra për shkak të mos inkasimit të borxhit në afatet ligjore, ka ardhur në shprehje zbatimi i institutit të parashkrimit të kërkesës së kreditorit për realizimin e një borxhi të tillë pa fajin e debitorit. Ne fund i propozon gjykatës që të aprovohet prapësimi i tij ndërsa Urdhri për lejimin e përmbarimit të refuzohet si i pa mbështetshëm juridikisht dhe të pa argumentuar pasi që edhe ashtu ka kaluar afati ligjor- parashkrimi për një kërkesë të tillë.

Kreditori SH.A. KUR "Mitrovica" J.S.C., me seli në Mitrovicë, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar prapësimin si të pa pabazuar dhe të pa arsyeshëm sepse propozimi për përmbarim i plotëson të gjitha kushtet ligjore të parapara në nenin 29 të LPP-së, për tu konsideruar dokument i besueshëm. Sa i përket pretendimeve të debitorit se borxhi është parashkruar ka theksuar se të njëjtat nuk qëndrojnë sepse në rastin konkret kemi ndërprerje të parashkrimit për arsye se debitori në vazhdimësi ka pranuar shërbimet e kreditorit por qëllimi i debitorit është, që të ikë përgjegjësi dhe obligimeve ku i njëjti ka bërë pagesa për ujin e shfrytëzuar, por jo në tërësi. Si provë lëndës i kemi bashkangjitur Ekstraktet e faturave nga Librat e Kontabilitetit ku shihet se debitori i ka pranuar faturat dhe ka bërë pagesë të obligimeve kohe pas kohe por jo në tërësi dhe shihet periudha e borxhit për të cilën kohe është i ngarkuar, kështu që konsideroj se Propozimi për përmbarim duhet të përmbushet duke u mbështetur në nenin 27 pika 1 dhe neni 29 pika 1,2 dhe 3 të LPP-së për pagesë. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të detyrohet debitori që në llogari të kreditorit në shumën e borxhit të mbetur prej 1,837.80€ dhe prapësimi i debitorit të hedhet poshtë si i pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi është pjesërisht i bazuar andaj të njëjtin e aprovoi pjesërisht dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktvendimi, ndërsa e refuzoi pjesën tjetër të prapësimin dhe vendosi si në pikën II të dispozitivit pasi gjeti se prapësimi në këtë pikë është i pabazuar, për shkak si në vijim:

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit i cili pretendon për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike pasi që për sasinë e harxhimit të ujit faturimin është bërë në mënyrë paushall dhe faturuar nga zyrat e sajë, të njëjtat pretendime nuk qëndrojnë për faktin se për borxhin e krijuar ekziston kartela e konsumatorit në të cilën evidentohet sasia dhe vlera e borxhit, ku propozimi është ngritur në bazë të kartelës financiare të konsumatorit (ekstraktit nga librat afarist), i cili konsiderohet dokument i besueshëm sipas nenit 29 par.1.2 të LPP-së, i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori

dhe kohën për të cilën është krijuar ky detyrimin duke e përfshi borxhin nga viti 31.03.2016 e tutje.

Me nenit 29 par. 3 të LPP-së, është përcaktuar se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Në rastin konkret dokumenti i besueshëm i përmban të gjitha elementet e parapara me dispozitën e cituar andaj përbën dokument të përshtatshëm për përmbarrim.

Duke vlerësuar pretendimet e debitorit lidhur me afatet e parashkrimit, gjykata pas vlerësimit të faturave kontestuese dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 360 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe paragrafi 2 të LMD-së (Ligji Nr.04/L-077), ka ardhur në përfundim se kërkesa e kreditorit pjesërisht është parashkruar.

Me dispozitën e lartcekur të Nenit 360 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se “1. Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake;”. Ndërsa me paragrafin 2 të Nenit 360 parashihet se: “Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”.

Në rastin konkret duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë nga fundi i vitit përkatës kur është lëshuar secila faturë, rezulton se kërkesat e kreditorit për periudhën prej 31.03.2016 deri me 31.12.2018, në shumën prej 1,445.50€, janë parashkruar në kuptim të nenit 360 paragrafi 2 të LMD-së, pasi që propozimi i kreditorit për përmbarrim është parashtruar me datë 18.12.2020 andaj të gjitha kërkesat e kreditorit që kanë arritur për pagesë para datës 31.12.2018, janë parashkruar sipas afatit një vjeçar.

Lidhur me pretendimet e kreditorit në përgjigje në prapësim se kemi të bëjmë me ndërprerje të parashkrimit sipas nenit 368 të LMD-së, për arsye se debitori i ka pranuar rregullisht shërbimet e ujësjellësit ky pretendim i kreditorit nuk qëndron sepse nëse debitori i ka pranuar shërbimet e ujësjellësit dhe të kanalizimit nga kreditori, nuk paraqet shkak për ndërprerje të parashkrimit, duke u bazuar në nenin 360 paragrafi 3 të LMD-së, i cili përcakton se: “Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë”. Andaj në këtë rast pranimi i shërbimeve nga ana e debitorit nuk ndërprejnë rrjedhën e parashkrimit.

Në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë me të cilën do të vërtetohej ndërprerja e parashkrimit. Madje nuk ka asnjë provë me të cilën do të vërtetohej as pohimi i borxhit nga debitori. Me nenin 368 paragrafi 2 përcaktohet se “parashkrimi ndepritet kur debitori e pranon borxhin”, por në nenin 372 të LMD-së theksohet se “Për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin”. Prandaj veprimet e ndërmarra nga kreditori nuk përbëjnë veprime të cilat kanë efekt në ndërprerjen e parashkrimit.

Prandaj, bazuar në të lartcekurat, Gjykata gjeti se kërkesa e kreditorit është parashkruar për pjesën e lartcekur, andaj pjesërisht e pranoi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe atë për shumën prej 1,445.50€, e anuloi pjesërisht urdhrin për përmbarrim P.nr.4977/2020 të datës 18.12.2020, të lejuar nga Përmbarruesi Privat, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Ndërsa sa i përket borxhit për periudhën kohore 01.01.2019 gjerë me datë datës 30.11.2020, gjykata gjeti se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim-parashkrim të borxhit të kreditorit në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, referuar nenin 360 par. 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji Nr.04/L-077), në të cilën parashihet që afati i parashkrimit për çdo kërkesë të arritur gjatë një viti, fillon të rrjedhë në fundin e atij viti e që në rastin konkret për të gjitha kërkesat e arritura në vitin 2019 afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë nga data 01.01.2020, i cili afat zgjatë deri më 31.12.2020 dhe në rastin konkret nuk kemi kalim të afatit të parashkrimit për këtë periudhë kohore, për faktin se më datë 18.12.2020 kreditori ka ushtruar propozim për përmbarim, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit konform nenit 369 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se debitori ka mbetur borxh ndaj kreditorit për shumën e cekur në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata lidhur me këtë pjesë të kërkesës së kreditorit e refuzoi prapësimin e debitorit dhe e la në fuqi urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.4977/2020 të datës 18.12.2020, i lejuar nga Përmbaruesit Privat, për shumën prej 392.30€, pasi që vlerësoi se borxhi për këtë shumë nuk është parashkuar.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit pranohet pjesërisht, si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sa i përket kamatës së aplikuar për detyrimin e aprovuar si në pikën **II** të dispozitivit, gjykata i është referuar nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë dhe konform dispozitave të nenit 5.5, 17, 29 par. 1.2 dhe par.3, 69,71 e 73 par.3 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, lidhur me nenin 329, 360 par.1, 2 dhe 3, dhe 368, 369, 372 dhe 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
PPP.nr.319/2023, datë 22.03.2024

Gjyqtari
Blerim Istrefi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë në afat prej shtatë (7) ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë. Ankesa parashtrohet përmes kësaj Gjykate.